VENDIM
Nr. 188, datë 25.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "NOA ENERGY TRADE" SHPK, NR. 262, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 7, DATË 2.2.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e"; të nenit 5, pika 1, germa "e"; të nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe të nenit 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 111/1 prot., datë 21.11.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë "NOA Energy Trade" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "NOA Energy Trade" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 728 prot., datë 11.11.2019, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Në datën 27.9.2014 është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me numër identifikimi (NUIS) L42203031A.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Referuar sa më sipër, konstatohet se shoqëria "NOA Energy Trade" sh.p.k. ka aplikuar brenda afatit ligjor për rinovimin e licencës.

- Aplikimi i shoqërisë "NOA Energy Trade" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 4.8:

- germa "b" (Kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie):

- Shoqëria "NOA Energy Trade" sh.p.k. ka depozituar në ERE një vërtetim nga Credins Bank, nr. 910 prot., datë 8.11.2019, ku rezulton se shoqëria është financuar në datën 28.7.2015, me një *overdraft*, por nuk ka paraqitur sasinë e kapitalit që vë në dispozicion për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimi të energjisë elektrike;

- germa "c" (Lista e kontratave të mëparshme, të realizuara, nëse ka pasur):

- Shoqëria ka listuar kontrata të mëparshme në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, por nuk ka paraqitur një dokument provues për realizimin e tyre, sipas kushteve të kontratës;

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë "NOA Energy Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, nr. 262, seria T15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 7, datë 2.2.2015, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-s
Erjola Sadushi